

BARDHYL DEMIRAJ

FORMANTI -TË NË SISTEMIN E NUMËRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

(Vështrim historik)

Prania në gjuhën shqipe e formantit -të te disa numërorë themelorë: *gjashtë*, *shtatë*, *tetë*, *nëntë*, *dhjetë* ka tërhequr prej kohësh vëmendjen e studiuesve të kësaj gjuhe. Kjo dukuri është bërë objekt studimi edhe nga një numër gjuhëtarësh indoevropianistë të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar e të fillimit të shekullit tonë. Duke trajtuar fazat e ndryshme të evolucionit që ka përshkuar tipi i lashtë indoevropian i sistemit të numërimit, ata janë përpjekur që të shpjegojnë edhe strukturën e numërorëve të gjuhës shqipe. Me këto përpjekje janë ravigjëzuar në një masë të konsiderueshme tiparet e përbashkëta dhe dalluese të strukturës së numërorëve të shqipes me ato të gjuhëve të tjera simotra indoevropiane. Natyrisht, për një numër çështjesh që lidhen me studimin e kësaj dukurie, gjuhëtarët nuk kanë arritur në një qëndrim të përbashkët.

Në këtë artikull do të bëhen përpjekje që, pas një shqyrtimi kritik të tezave kryesore të hedhura gjer më sot, të sjellim ndonjë argument të ri në lidhje me zanafilën, funksionin fillestar të këtij formanti dhe shtrirjen e tij në krye të herës. Shënojmë që në fillim se gjatë trajtimit të çështjeve të ndryshme që lidhen me fazat e hershme e të padokumentuara të shqipes, çdo argumentim i ri nuk i kalon kufijtë e hipotezës. Kjo kushtezohet edhe nga fakti se për një numër çështjesh, kryesisht të fonologjisë historike të shqipes, nuk është thënë ende fjala e fundit.

1. Origjina e formantit -të te numërorët themelorë 6-10 në gjuhën shqipe është parë gjithmonë në lidhje të ngushtë me funksionin e tij fillestar. Dhe për këtë gjuhëtarë të ndryshëm kanë dhënë dy shpjegime. Ose ky formant të ketë shërbyer për ndërtimin e numërorëve rrështorë, të cilët në një fazë të caktuar erdhën e u përdorën edhe me funksionin e numërorëve themelorë, siç mendon Fr. Bopi¹; ose ai të ketë shërbyer në zanafillë për ndërtimin e emrave abstraktë e kolektivë (Zahlabstrakta).

¹⁾ Fr. Boop, *Das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen*, 1854.

sic mendojnë G. Majeri², K. Brugmani³, H. Pedersen⁴, E. Çabej⁵, Semerenë etj.⁶

Sipas Fr. Bopit, formanti *-të* te numërorët 6-10 në gjuhën shqipe është identik me formantin e rreshtorëve **-tā*⁷: gr. *-to*, lat. *-to*, sll. e vj. *-tb*, lit. *-ta*. Në një përfundim të tillë ai vjen, pasi shqyrton zhvillimin fonetik të këtij formanti në gjuhën shqipe. Një kalim të ngjashëm të numërorëve rreshtorë me funksion themelori ky gjuhëtar e vëren gjithashtu edhe për një numër gjuhësh i.e., si latinishtja, slavishtja e vjetër etj., të cilat njojin edhe formantin tjetër të rreshtorëve **-m-*, **-mā* (**-(m)mo-s*: shén. 7): lat. *septem* — *septimus*, *novem* — *novimus (nonus)*, *decem* — *decimus*; sll. e vj. *sedmъ* «i shtatë», *osmъ* «i tetë»⁸.

Kësaj teze i bie ndesh teza tjetër që e krahason formantin *-të* të shqipes me formantin e dikurshëm i.e. **-t-*, **-ti*: ind. e vj. *-t-*, *-ti*, gr. *-αδος*, sll. e vj. *-tb*, lit. *-ti* (Sh. § 5.1/a). Sipas kësaj teze, ky formant në disa gjuhë i.e. u është bashkëngjitur edhe numërorëve të thjeshtë 5...10, në zanafillë mbiemra të palakueshëm⁹, duke i shndërruar ata në numërorë — emra abstraktë me kuptimin «një pesëshe... një dhjetëshe»: ind. e vj. *pank'tí-h* «një pesëshe», *dašat* dhe *dašati-h* «një dhjetëshe»; në greqishtë emrat femërorë më *-αδος* : δεκάδος «një dekadë»; sll. e vj.: *pętъ*, *šestъ*, *devetъ*, *desetъ* «një pesëshe, një gjashtëshe, një nën-tëshe, një dhjetëshe»; lit. *dėszimtis* «një dhjetëshe». Në këtë kuadër mbrojtësit e kësaj teze fusin edhe formantin *-të* të shqipes për numërorët 6...10, «në vend të numërorëve-mbiemra të zhdukur»¹⁰. Sipas kësaj

-
- 2) G. Meyer, *Albanesische Studien II, Die albanesischen Zahlwörter*, 1884, f. 49-52; si edhe në *Albanesische Studien III*, 1892, f. 14.
- 3) K. Brugmann — B. Delbrück, *Grundriss*, II, 2 (bot. i par), f. 20.
- 4) H. Pedersen, *Die Gutturale im Albanesischen*, në KZ 36, f. 284-291, 307.
- 5) E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, fjala dhjetë (e pabot.). Në fillim ky gjuhëtar ka mbrojtur tezën e Bopit; shih pér këtë A. Xhuvani — E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tirane, 1962, f. 90.
- 6) Szemerényi, *Studies in the Indo-European System of Numerals*, Heidelberg, 1960, f. 104 v. Shih ndërsa tjerë edhe G. Shmidt, *Zum Problem der germanischen Dekadenbildung*, në KZ 84 (1970) f. 121, 135, 132; R. Köderritzsch, *Zu den sprachgeschichtlichen Grundlagen des Albanischen von heute*, në «*Studia albanica*», 2, 1985, f. 124 v.
- 7) Tanimë është vërtetuar që formantet e dikurshme të rreshtorëve janë **-to* dhe **-(m)mo-s*, ndërsa një **-a* tek *-ta* dhe *-mā* është shenjues i gjimisë femërore njëjës. Shih Brugmann, *vep. cit.*, f. 50; Th. Simenschy I — Gh. Ivănescu, *Gramatica comparată a limbilor indoeuropene*, Bucureşti 1981, f. 278 v. Në këtë artikull ne do të operojmë me formantin *-to*, gjin. fem. *-ta*.
- Ndryshe mendon O. Szemerényi në *Introduzione alla linguistica indoeuropea* 1985, f. 264; sipas këtij sufiksi i mirëfilltë i rreshtorëve i.e. është **-o*, ndërsa formimi më **-to*, është riformim i mëvonshëm i përfthuar në saje të ndikimeve analogjike.
- 8) Ky gjuhëtar i kundërshton këtu lidhjet që kishin vendosur përparrë tij midis formantit *-të* të shqipes me *-tb* të slavishtes së vjetër (Shih edhe § 6.1). Për afërinë e shqipes me slavishten e vjetër shih edhe G. Meyer, *Albanesische Studien II*, f. 52.
- 9) Në indoeuropianishten primitive numërorët, kur përdoreshin më bashkëvajtje me emrat dilnin më dy përdorime. Numërorët 1...19 dilnin si mbiemra (*Zahladiktiva*), ndërsa tjetë 1...4 ishin të eptueshëm, ndërsa 5...19 të paëptueshëm. Numërorët 20 e lart dilnin me funksion emëror (*Zahlsubstantiva*). Shih ndërsa tjetër edhe Brugmann, *vep. cit.*, f. 5.
- 10) Brugmann, *vep. cit.*, f. 21-22.

teze, ky kalim i numërorëve-mbiemra të palakueshëm në emra bëri që emri që shënon objektin e numërueshëm, kuptimi i përcaktuar prej tyre, të shndërrohej në një gjymtyrë të nënrenditur me funksion atributiv në rasën gjinore shumës. Shemb: lit. *dëszimt výrū* «dhjetë burra, përkth. fjalë pér fjalë: një dhjetëshe e burrave»; sll. vj. *pëtë chlëbë* «pesë bukë; një pesëshe e bukëve» etj. Por, meqenëse në ndonjë gjuhë si shqipja nuk ekziston një status i tillë sintaksor i numërorëve, Brugmani mendon se në një fazë të mëvonshme në këtë gjuhë dhe në ndonjë tjetër ky status u riorganizua: «Numërorit — emër iu caktua roli i përcaktorit atributiv të objektit të numëruar»¹¹, d.m.th. numërorët 6...10 të shqipes u rishndërruan në njësi sintaksore të nënrenditura si përcaktorë pa përshtatje. Ndërsa në gjuhë të tjera si sillavishtja e vjetër dhe lituanishtja statusi i vjetër u ruajt. (Shih §§ 2, 5.1).

2. Lidhur me pohimet që kanë bërë pér shqipen gjuhëtarët që mbështesin tezin e dytë, do vërejtur se në këtë gjuhë që në dokumentimet më të hershme të saj, duke përfshirë këtu edhe të folmet e diasporës, nuk ndeshen gjurmë të përdorimit të numërorëve 6...10 me funksion emëror, d.m.th. që të kërkojnë emrin pas tyre në rasën gjinore ose në ndonjë rasë tjetër të zhdrojtë të përdorur me kuptim partitiv¹². Në të gjitha dëshmitë e mbledhura gjer më sot, numërorët 6...10 në shqipe dalin me funksionin e një përcaktori të vetëmaftueshëm të emrit që ata kuptimisht përcaktojnë¹³. Shemb.; Tek Buzuku: Këtu zanë ȝfill të *shtatë Psalmat Pencialë* (f. 41), Këtu u sosnë të *dhjetë ordënatë* (f. 65); tek Matrënga: Ku i dha inazot këta të *dhjetë urdhër*. Këta të *dhjetë urdhër* mbë sa mbahenë (Foglio 31) Të të *shtatë mkatët* të parë çë kluhenë se vrasënë (Foglio 32 v); tek Reinhold-i: Ti ne do muanë shok / baie besënë ka fort / katër, pesë, gjashtë mot; Pér të mblosh p'sa *gjashtë ambarë* / e të ndash dhe gjettëk farë. (në «Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar», I, 1961, f. 99, 106).

Sic shihet edhe nga shembujt e mësipërm, në togfjalëshat numëror + emër, numërorët funksionojnë si një gjymtyrë sintaksorisht e nënrenditur, funksion ky i lidhur ngushtë me kuptimin leksikor kategorial të klasës së numërorëve. Në këtë pikë shqipja largohet mjafit nga gjuhët e tjera i.e. që janë sjellë gjer më sot pér krahasim, si sillavishtja e vjetër, lituanishtja e ndonjë tjetër. Në këto gjuhë numërorët në shqyrtim dalin në funksion të ngjashëm me atë të emrit. Pra, dalin rregullisht si gjymtyrë gramatikisht kryesore që kërkon emrin që shënon objektin e numëruar, në rasën gjinore shumës. Shemb: sll. e vj. *pëtë ženç* «pesë gra; përkth. fjalë pér fjalë: një pesëshe e grave»; lit. *asz*

¹¹) Brugmann, *vep. cit.*, f. 23.

Pér nga funksioni sintaksor ne do t'i marrim këta numërorë si përcaktorë të vetëmaftueshëm, term i përdorur nga Sh. Demiraj, në *Reth vendit të përcaktorëve në gjuhën shqipe*, «Studime filologjike», 1981, 3, f. 72.

¹²) Këtu nuk është fjalë pér togfjalëshat e tipit *dy prej shokëve, gjashtë nga shokët, dhjetë ndër shokë*. Në këtë rast është parafjala ajo që i jep kuptimin partitiv gjymtyrës së dytë të togfjalëshit.

¹³) Ky formant krahas numërorëve bazë 6...10 del edhe te numërorët e pathjeshtë të sistemit dhjetësh të numërimit, të cilët kanë në përbërjen e tyre si element përbollës fjalën *dhjetë*. (Shih § 4.2.3).

pirszaū dëszimti arkliū «Bleva dhjetë kuaj : një dhjetëshe e kuajve» (Në lituanishtë del me këtë funksion vetëm numërori dhjetë: *dëszimt*). Një ndërtim i tillë është edhe në gjuhët e reja sllave¹⁴. Shemb : sr.kr. pet konja «pesë kuaj: një pesëshe kuajsh»; rus. пять студентов «pesë studentë: një pesëshe studentësh» etj.

3. Në këto rrrethana sintaksore, duke u mbështetur në të dhënëat që na japid fazat e hershme të shqipes së dokumentuar, shohim si më të përligjur mundësinë që, në zanafilë, ky formant të ketë pasur funksion fjalëformues mbiemrëror. Megjithatë, një zgjidhje e drejtë e kësaj çështjeje bën të nevojshme shtrirjen e studimit të këtij formanti në një kuadër më të gjerë, duke shqyrtuar aftësinë e tij fjalëformuese në gjuhën shqipe. Me fjalë të tjera, çështja shtrohet kështu: Çfarë elementi fjalëformues ka qenë formanti -të në gjuhën shqipe? A ka shërbyer ai në shqipe për formimin e emrave abstraktë, apo ka shërbyer që herët në formimin e mbiemrave? Apo kemi të bëjmë këtu me një ndërthurje të dy a më shumë formanteve i.e. me funksion të ndryshëm fjalëformues, të cilët, duke u ndodhur në pozicion fundor e jashtë theksit, kanë bjerrë ose errësuar në -ë zanoren fundore?

3.1. Funksioni themelor i këtij elementi fjalëformues në shqipe është formimi i mbiemrave, ku si temë fjalëformuese mund të shërbejë: një temë emërore: *ar* — *i artë*, *dru* — *i drunjë*, *zjarr* — *i zjarrë* etj.; një temë ndajfoljore: *afér* — *i afért*, *larg* — *i largët*, *tepér* — *i tepért* etj.; një numër: *dy* — *i dytë*, *pesë* — *i pestë*, (por *gjashtë* — *i gjashtë*)¹⁵. E me këtë funksion ky formant mund të sillet vetëm nga i.e. *-to¹⁶.

Me anën e formantit -të (< *-to), krahas formantit -n(ë) / -r(ë) < *-no, ndërtoheshin në shqipe edhe pjesoret e kryera me kuptim pësor për një numër foljesh si: *ba-të*, *kla-të*, *lë-të*; *pi-të* etj., si edhe pjesoret e ndajfoljëzuar *tha-të*, *ra-të*, *ngroh-të*¹⁷. Por këtu kjo prapashtë me këtë funksion nuk është origjinare. Ky formant, ashtu si formanti tjetër i.e. *-no > shq. *n(ë)* / *r(ë)*, shërbente në zanafilë për ndërtimin e mbiemrave foljorë. Në një fazë të caktuar të evolucionit të shqipes, të dy këto formante erdhën e u përdorën edhe për ndërtimin e formës së pjesores së kryer pësore, në vend të formantit të mërfilltë të saj *meno, *-mo > shq. *-m(ë)*¹⁸.

14) Ndër gjuhët e reja sllave të Ballkanit bëjnë përjashtim bullgarishtja dhe maqedonishtja, si gjuhë që e kanë bjerrë lakimin e emrit. Shemb: bulig. три тетрадки (tri fletore) пет тетради (pesë fletore), мац. две жени (dy gra), пет жени (pesë gra).

15) Si variante dialektore ndeshen edhe formimet: *i gjashtë*, *i shtatë* etj.

16) Shih, ndër të tjerë, A. Xhuvani — E. Çabej, *vep. cit.*, f. 90.

17) Sh. Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, II, 1976, f. 186. Formime të tillë ndeshen edhe sot në disa të folme të gegërishtes. Shih M. Domi, *Morfologjia historike e shqipes*, Tiranë, 1960, f. 66.

18) Brugmann, *Grundriss*, 2, I, f. 394v.

19) Për zhvillimin e mbiemrave foljorë më *-to në shqipe shih edhe G. Meyer, *Albanesische Grammatik*, Wien, 1888, f. 43; M. Domi, *Morfologjia historike e shqipes*, Tiranë, 1961, f. 63; Sh. Demiraj, *vep. cit.*, f. 182.

Format e pjesores më -të kanë marrë përsëri sot në shqipe nëpërmjet para-nyjëzimit kuptim mbiemrëror : *i kulluet*, *i plotë*, *i thatë* etj. Ndërsa format më -m(ë) dhe -r(ë) e ruajnë kuptimin e pjesores: *i kulluar*, *i kulluem*, *i tharë*, *i ngrirë* etj. Shih A. Xhuvani — E. Çabej, *vep. cit.*, f. 90.

Historikisht -të (< *-to) del si një formant më vete edhe te disa emra femërorë të moçém si *dritë*, *ditë*, *latë*, si edhe tek emri abstrakt *përzitë* «bashkim»²⁰. Por edhe në këto raste ky formant me këtë funksion nuk është origjinar. Tanimë është vërtetuar që emrat në shqyrtim janë formime me konversion nga pjesoret e foljeve gjegjëse, si pjesore më -të : *ditë* : *gdhi-hem*, *dritë* : *ndrij*, *latë* < *lap-ta : *lëpij*, *përzitë* : *përziej*²¹.

Duke u nisur nga këto fakte morfologjike nxjerrim përfundimin se funksioni themelor klasifikues i formantit -të në shqipe është ai mbiemëror. E në këtë funksion ai mund të sillet i prejardhur vetëm nga gjegjësi i.e. *-to²².

3.2 Megjithatë nuk mund të pretendojmë se argumentet që vijnë në të mirë të mendimit mbi një element fjalëformues me funksion klasifikues mbiemëror *-t(o)²³, e vërtetojnë katërcipërisht atë. Kështu nuk përashtohet mundësia që në një fazë të caktuar të evolucionit të shqipes ky formant të ketë kryer edhe funksionin e një elementi fjalëformues emëror²⁴. Për këtë, një vend të veçantë në analizë zë fjala *dhjetë*, e cila dallohet për natyrën e saj të dyfishtë leksiko-gramatikore, që përkon me përdorimin e saj si numëror dhe si element përbërës i rrafshit dhjetësh të numërimit.

4. Në të gjitha gjithët i.e. që njohin sistemin dhjetësh të numërimit, fjala *dhjetë* del me dy përdorime. Nga njëra anë, ajo përdoret si numëror që shënon një sasi të caktuar objektesh të numërueshme, ashtu si numërorët 1...9 : *dhjetë burra*, *dhjetë gra*. Në këtë përdorim ajo del që në zanafilë me natyrën leksiko-gramatikore të një mbiemri të palakueshëm (shën. 8). Nga ana tjetër, kjo fjalë përdoret edhe si një element përbërës që shënon rrafshin dhjetësh të numërimit në kompozitat tridhjetë... nëntëdhjetë. Kur përdorej si element përbërës, kjo fjalë, ashtu si edhe fjalët që shënonin rrafshet qindësh dhe mijësh të numërimit, funksiononte si një emër i gjinisë femërore, përkatësisht asnjanëse. Ndërsa përsi i përket elementit tjetër të kompozitës (numërorët 2...9), ky qëndronte përparrë si mbiemër²⁵.

Sipas Brugmanit (shën. 25), në gjuhën shqipe fjala *dhjetë* dilte si një emërasnjanës në rasën emërore-kallëzore shumës. Ky supozim duket i përligjur, në rast se merret në vështrim numërori *tridhjetë*, ku fjala *dhjetë* është element përbërës i kompozitës. Elementi i parë i kompozitës, numërori *tri*, është i vetmi ndër numërorët e thjeshtë që në gjendjen e sotme të gjuhës përshtatet në gjini me emrin që përcakton:

20) Ka mbetur ende e pasqaruar mirë etimologjia e emrave konkretë: *det* dhe *botë*, për të cilët mendohet se janë formime më -të < *-to.

21) A. Khuvani — E. Çabej, *vep. cit.*, f. 90-91.

22) Brugmann, *Grundriss*, 2, I, f. 394v; Por, sipas tij, ky formant del ndonjëherë edhe me funksion emëror, për të ndërtuar emrat abstraktë. Shih edhe Th. Simenschky — Gh. Ivănescu, *vep. cit.*, f. 278.

23) Mbetet ende për t'u sqaruar fati i një prapashtese të mundshme i.e. *-t- në shqipe, i cili mbrohet më shumë nga Szemerényi, *vep. cit.*, f. 105, Sipas Brugmanit, *vep. cit.*, f. 422, ky formant qëndron nga njëra anë në lidhje të ngushtë me formantin *-to, nga ana tjetër me *-ti.

24) Shih shënimin 21.

25) Brugmann, *Grundriss*, II, 2 (1 Aufl.), f. 30.

tre burra, tri gra. Forma e ngurosur e gjinisë femërore *tri* shënonte në zanafillë gjininë asnjanëse dhe lidhet me formën e rindërtuar tëasnjanësit **tri²⁶*. Ruajtja e formës së vjetër tëasnjanësit tek kompozita *tridhjetë* dëshmon se ai në zanafillë i është përshtatur në gjini dhe rasë fjalës *dhjetë*, e cila në këtë përdorim nuk mund të funksiononte më si numëror i thjeshtë, por si një fjalë-emër që shenjonte një rrafsh të caktuar të numërimit me kuptimin «dekadë, një dhjetëshe», njëloj siç dalin si emra të gjinisë mashkullore fjalët *zet, qind* etj., kur shenjojnë rrafshet gjegjës të numërimit: *trezeti, treqind* etj.²⁷.

4.1. Natyra e dyfishtë leksiko-gramatikore e fjalës *dhjetë* që del gjatë përdorimeve të saj si numëror i mirëfilltë dhe si element përbërës që shëndon rrafshin dhjetësh të numërimit, nxjerr në pah për shqipen një numër problemesh që, në një mënyrë a në një tjeter, lidhen me funksionin klasifikues burimor të formantit -*të* te kjo fjalë.

Në shumicën e gjuhëve i.e. për dy përdorimet e fjalës «dhjetë» janë përfshuar dy leksema të ndryshme. Kështu, ndërsa numërori *dhjetë* është përfshuar nga një temë mbiemërore **dekm²⁸* : ind. e vj. *daša-*, gr. δεκά; lat. *decem, dec*; av. *dasa*; arm. *tasn* etj., elementi përbërës «dekadë» është përfshuar nganjë temë emërore me -*t-* : *[d]kom-*t(o)*, *[d]km̃-*t(o)*, *komt-, *kmt-, *kmto²⁹ : ind. e vj. -*sat-*; gr. νάτ-, lat. *gint*, etj. Siç shihet, në këtë përdorim të dytë është elementi -*t-* ai që i ka dhënë fjalës *dhjetë* «dekadë» natyrën leksiko-gramatikore të emrit.

Ndryshe nga këto gjuhë, në gjuhën shqipe dhe në ndonjë gjuhë tjeter, fjalë «dhjetë» në të dyja përdorimet del e përfshuar nga një temë më -*t-*; shq. *dhjetë*; sll. e vj. *desət-*; lit. *dēszimt-*. Në këtë rast të bie në sy përngjasimi i madh midis elementit fundor -*t-* të kësaj forme me formantin -*t-* me funksion klasifikues emëror i cili del te forma bazë i.e. *[d]kom-*t*, *[d]km̃-*t(o)* dhe me të cilin shumica e gjuhëve i.e. kanë ndërtuar elementin përbërës të rrafshit dhjetësh. Ky përngjasim e bën të mundshëm supozimin që elementi fundor -*t-* në shqipe të ketë pasur në zanafillë funksion klasifikues emëror që shërbente për ndërtimin e elementit përbërës të rrafshit dhjetësh dhe që më vonë erdhë e u përdor edhe si numëror, ndërsa për sa u përket numërorëve 6...9, ai të jetë përfshuar në rrugë analogjike³⁰.

Në të njëjtat përfundime të çon edhe teza e mbrojtur nga H. Hirti, M. Blankenshtajni dhe e zhvilluar më tej kohët e fundit nga O. Semerenei, sipas së cilës tingulli fundor -*t tek* **dékmt* nuk është një formant fjalë-formues, por një element fundor i një temë i.e. emërore **dékmt-*. Ndërsa tema mbiemërore **dékmt-* që del për numërorin «dhjetë» në shumicën e gjuhëve i.e., sipas kësaj teze, është një formim i mëvonshëm regresiv³¹.

26) G. Meyer, *Albanesische Studien* II, f. 47; Brugmann, *vep. cit.*, f. 11. O. Szemerényi, *Introduzione alla linguistica indo-europea*, 1985, f. 260.

27) Në gjendjen e sotme të gjuhës edhe fjalët që shenjojnë rrafshet milionësh e miliardësh të numërimit dalin si fjalë emra.

28) Brugmann, *vep. cit.*, f. 23; Th. Simeschy — Gh. Ivănescu, *vep. cit.*, f. 310.

29) Brugmann, *vep. cit.*, f. 30, 35.

30) Pedersen (në *vep. cit.*, f. 284) mendon se formanti -*të* te numërorët 6...9 është shtuar në rrugë analogjike nga numërori *dhjetë*.

31) H. Hirt, *IF. Anzeige* 9, f. 28; M. Blankenstein, *IF* 21, f. 110-111, O. Szemerényi, *Numerals...*, f. 68 v. Sipas këtij të fundit, **dékmt* «is the original form of which **dékmt* is a secondary modification», «is the proconsonantal sandhivarient of **dékmt*». Megjithëse për shqipen ai ka tjetër mendim (Shën. 6).

Jo pa interes është teza e mbrojtur nga R. Këderic në artikullin e cituar, f. 123. Ai pranon një formant $*-tV$ - vetem për numërorët *gjashtë*... *nëntë*. Ndërsa numërorin *dhjetë* e nxjerr nga i.e. **dék^m* nëpermjet një forme parashqiptare të rindërtuar *^odhjethun*, ku, me kalimin e kohës, ka ndodhur — sipas tij — një proces disimilimi spirantesh *dh...th* $>$ *dh...t* dhe apakopa e tingujve fundore *-un* $>$ \emptyset . Në këtë rast po mjaftohemi vetem me objekzionin që procesi i disimilimit presupozon një periudhë të hershme parashqiptare; çka vështirë se mund të pranohet, për vetë faktin se këta tinguj në statusin e sotëm fonologjik si fonema të spirantizuara /d/ e /θ/ janë përfshirë në periudhën historike të shqipes^{31/1}.

4.2. Në këto rrrethana, për elementin fundor *-t* te fjala *dhjetë* në gjuhën shqipe dalin këto probleme:

a. A është elementi fundor *-t-* te *dhjetë* një element fundor tematik, apo është një element shtesor fjalëformues i mëvonshëm?

b. Në rast se është një element fjalëformues, çfarë funksioni ka pasur ky formant në zanafillë për gjuhën shqipe? A ka pasur ai një funksion klasifikues emëror, i cili në zanafillë të ketë shërbyer për ndërtimin e elementit përbërës të rrëfshit dhjetësh e që me kalimin e kohës erdhi e u përdor edhe si numëror? Apo ka ndodhur një proces i përkundërt: të ketë pasur në zanafillë funksion mbiemëror, që ka shërbyer për ndërtimin e numërorit *dhjetë*, i cili erdhi e u përdor edhe si element përbërës me kuptimin «dekadë», duke u shndërruar në emër me anë konversioni?

c. Çfarë shkallë shtrirjeje ka pasur ky element fjalëformues në zanafillë? A është përfshirë në fillim vetem te fjala *dhjetë*, apo është përfshirë njëherë tek të gjithë numërorët *gjashtë*...*dhjetë*?

4.2.1. Për sa i përket problemit të parë, siç do të shtjellohet këtu më poshtë, me të dhënat e derisotme të fonologjisë historike të shqipe shohim si më të përligjur mendimin që në shqipe elementi fundor *-t-* tek *dhjetë* është një element shtesor i mëvonshëm. Pra kemi një formë të rindërtuar **dék^m-t(o)*.

Bashkëtingëllorja dentale *t* te *dhjetë* është përfshirë nga asimilimi i grüpuit *Kt*³², siç është vërtetuar edhe te një numër fjalësh që kanë pasur në trup të tyre njëra pas tjetrës një guturale palatale dhe një dentale: shq. *tetë* $<$ **oktō-t-* e krhs. me lat. *octo*; gr. ὀκτώ etj.; shq. *dritë* (ndrij) $<$ **derk-t-* etj. Por grupi *Kt* tek **dék^mt* do të përfshirë vetem nëpermjet rënies së sonantes rrokjeformuese *m*. Nga ana tjetër, bjerrja e kësaj sonanteje mund të motivohet vetem në rast se do të jetë ndodhur në pozicion fundor. Në rast të kundërt sidomos para dentales *t*, ajo nuk

^{31/1} Shih përfshikimet e këtyre tingujve më gjérë: H. Pedersen, *vep. cit.*, f. 340; H. Ölberg, *Zwei oder drei Gutturalreihen*, në «Scritti in onore di Giuliano Bonfante», Brescia, 1976, vol II, f. 567. Për rastin në shqyrtim nuk mund të bëhet fjalë për një proces disimilimi tektallesh të aspiruara të periudhës indoevropiane *th* \rightarrow *t/t^hV* - (i ashtuquajturi ligj i Grassmanit). Më hollësisht përfshirë këtë proces fonologjik shih M. Mayrhofer, *Indogermanische Grammatik*, Heidelberg, 1986, vëll. I -1/2, f. 112-113).

³² Shih G. Meyer, *Albanesische Studien III*, 1892, f. 14. Sipas këtij gjuhëtari, numërori *dhjetë* në shqipe ka kaluar nëpër këto fazat: **dék^m*: *+dék^m-ti* $>$ **dék-ti* $>$ *dhjetë*.

kishte arsyе fonetike të binte. Sipas mendimit mbizotërues, sonantja *m* e ndodhur në pozicion jashtë theksit do të zberthehej në një zanore dhe në një bashkëtingëllore hundore *m/n*. E që këtej grupi *mt/nt* do të ndiqte rrugën e evolucionit *-mt > -nt > -nd (-nn > -n)*³³. Por çështja e reflekseve të sonanteve në gjuhën shqipe, për mendimin tonë është ende e hapur.

4.2.2. Për sa i përket problemit të dytë, të dhënat e gjuhës shqipe të çojnë në përfundimin se është më i përligjur gjuhës sht supozimi që e sheh elementin *-t*, te fjala *dhjetë* < **dekm̩-t-* si një element fjalëformues me funksion klasifikues mbiemër, i cili në zanafillë të ketë shërbyer për përfimin e numërorit gjegjës dhe që më vonë erdhi e u përdor edhe me cilësinë e elementit përbërës të rrafshit dhjetësh të numërimit, dulke kaluar kështu në klasën e emrave me anë konversioni. (Sh. §§ 4.2.; 4.2.1.) Në të mirë të kësaj teze vijnë edhe disa përfundime që dalin nga përgasja e fjalës *dhjetë* < **dekm̩-t-* të shqipes me elementin përbërës të numërorëve dhjetësh të përfuar në shumicën e gjuhëve i.e. nga forma e rindërtuar *[d]k̩om̩-t, *[d]k̩m̩-t(o) **k̩omt-*, **k̩mt-*, **k̩mto* : ind. e vj. *sat-*, gr. *κατ-*, lat. *gint-* etj.

Në gjuhët e ndryshme i.e. elementi përbërës me kuptimin «dekadë» ka pësuar ndryshime të dukshme në rrokjen nistore, gjë që ka çuar në errësimin e lidhjeve të dikurshme me format bazë të indoevropianishtes primitive, nga të cilat janë përfstuar. Këto lidhje janë errësuar edhe me shumë në fazat e vona, p.sh. : në gjuhët romane: it. *ve-nti*, *tre-nta* etj., fr. *vi-ngt* [vɛ̃], *tre-n-te* [trāt] etj., në gjuhët gjermanike : angl. *twe-nty*, *thir-ty* etj., gjerm. *zwan-zig*, *dreissig* etj. Në të gjitha këto gjuhë ish-elementi i dytë i kompozités është shndërruar me kohë në rolin e një prapashtese. Ndryshe nga këto gjuhë, shqipja karakterizohet nga një tejdukshmëri strukturore e numërorëve kompozita; fjalë *dhjetë* edhe në gjendjen e sotme të gjuhës paraqitet me të njëjtën përbërje fonetike edhe në dhjetëshet e përbëra (krhs. *tri-dhjetë*, *pesë-dhjetë* etj.), ç'ka dëshmon se ato, si fjalë të përngjitura, s'duhet të jenë fort të hershme. Në përngjitet e vjetra të shqipes elementi i dytë ka pësuar gjithmonë bjerrje të fuqishme : *sot < so dite*, *sonte < so nate*.

Në këtë rrethana, do të vihej në dyshim teza që e sheh fjalën *dhjetë* të shqipes si një fjalë që në zanafillë funksiononte si një element kompozicional i rrafshit dhjetësh e që më vonë erdhi e u përdor edhe me funksionin e një numërori të mirëfilltë. Në një rast të tillë, kjo fjalë, të paktën kur përdorej si element përbërës duhej të pësonte një fat të ngjashëm si gjegjëset e saj në gjuhët simotra. Prandaj ne e shohim si më të përligjur mundësinë që numërori dhjetë në shqipe, në një fazë të caktuar të evolucionit të gjuhës erdh e u përdor edhe si element përbërës

33) Shih për këtë G. Meyer, *Albanesische Grammatik*, Leipzig, 1888, f. 32. E. Çabej, (i cili citon La Pianën) në *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe. Fonetika historike e shqipes*, Tiranë, 1962, f. 76. Për reflekset e sonanteve *n*, *ŋ*, në shqipe shih edhe R. Köddenitzsch, *art. cit.*, f. 113v

emëror me kuptimin «dekadë», ndërsa kalimi nga klasa e mbiemrit në atë të emrit të jetë bërë me anë konversioni³⁴.

4.2.3. Zgjidhja e këtij problemi është premisë edhe për zgjidhjen e problemit tjetër që ka të bëjë me shkallën e shtrirjes së elementit fjalë-formues -të në krye të herës. Në rast se do të vërtetohej bindshëm kalimi i fjalës *dhjetë* nga një element që shenjonte rrafshin dhjetësh të numërimit edhe në një element me funksionimin e një numërori të mirëfilltë, atëherë do të dilte e qartë që formanti -të te numërorët gjashtë... nëntë është një shësë analogjike e mëvonshme. Porse të dhënat na çojnë në një drejtim të përkundërt: ky formant do të jetë përfshuar në zanafillë tek fjala «dhjetë» me funksion numëror. Si i tillë ai pritet të jetë përfshuar në të njëjtën kohë te të gjithë numërorët gjashtë-dhjetë, të cilët, në një fazë të caktuar të evolucionit të shqipes rezultojnë të kenë pasur të njëjtat karakteristika strukturore, morfologjike e sintaksore. (Shën. 8 dhe §§ 2).

Porse një pohim i tillë mbetet i mbështetur, sot për sot, vetëm në planin gramatikor e fjalë-formues. Ndërsa një përfundim bindës në planin fonologjik kërkon një trajtim shterues të ecurisë kronologjike në zhvillimin e disa proceseve fonologjike. Mjaftohemi të përmendim këtu çështjet që dalin nga trajtimi i grupeve -kt-, -kst-, -nt- në fazat e ndryshme të zhvillimit të shqipes. Ndër to, qartësi më e madhe kronologjike vërehet në trajtimin e grupit -kt-. Siç e pamë edhe më lart (§ 4.2.1), ky grup bashkëtingëllorësh në fjalët e fondit autokton është reduktuar në -t-. Ndërsa në periudhën e ndikimit latin në shqipe ky grup përfundon në *ft* : lat. *lucta* > shq. *luftë*, lat. *cotoneus* > shq. *ftua*, dhe (*j*)t : lat. *directus* > *drejt*; lat. *fructus* > shq. *fru(j)t* etj.³⁵ Për pasojë edhe formëzimi i numërorit *dhjetë dekëm-t(o)-* si një strukturë e veçantë fjalë-formuese, pas gjithë gjasash, shkon deri para periudhës së ndikimit latin në shqipe. Nuk mund të përjashtohet nga kjo periudhë as grupi -nt- që del tek numërori *nëntë*. Ky grup duket të jetë mirëruajtur edhe në fjalët e fondit autokton: *ndodh*, *dhandër*, *thundër*, *ndjek* etj.³⁶ Ndërsa zhvillimi i grupit -kst- kërkon një shqyrtim të mëtejshëm³⁷.

4.2.4. Ndërkaq, mbetet pér t'u shpjeguar se përsë ky formant nuk shfaqet dhe te numërorët e tjerë të parë (1...5). Por, ndërsa pér nu-

34) Si rrjedhim tingulli fundor -ë tek elementi përbërës *dhjetë* i rrafshit kompozicional (*tridhjetë... nëntëdhjetë*), rezulton të jetë refleksi i mbaresës së shumësit të gjinisë asnjaniçëse *-ā. Shih pér refleksin e kësaj mbarese Sh. Demiraj *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 1973, f. 52 dhe shën. 31.

35) Shih E. Cabej, *Hyrje...*, f. 109.

36) Shih G. Meyer, *Alb. Studien*, III, f. 24. Çështja e një reflektimi të mëtejshëm të grupit -nd- (> nn > n) është parashtuar vetëm në rastin e përfshimit të rasës kallëzore. Shih pér këtë Sh. Demiraj, *Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1975, f. 96, ku jetet literatura përkatëse pér gjithë mbështetësit e kësaj teze. Në gjendjen e sotme të gjuhës një kalim i grupeve *nt-/nd- > n*, është me bazë dialekto. Shih pér këtë J. Gjinari, *Dialektologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1975, f. 113.

37) Sipas G. Meyerit në *vep. cit.*, f. 62, grupi *kst-* në shqipe pér një periudhë të hershme ka përfunduar në -tħt- : *i djathë *deks-to*. Ndërsa tek *gjashtë*, sipas tij formanti -t- është shtuar trajtës tashmë të formuar *gjash-*. Do shënuar këtu se i *djathë* është i vetmi shembull që sjellin gjuhëtarë pér refleksin *tħt* të grupit *-kst. Shih pér këtë edhe H. Pedersen, *vep. cit.*, f. 291. Ndërsa E. Cabej në SF. 2, 1970, f. 89v: pranon *sh* si refleks të grupit *ks* : *puks > push, *ekst- > jashtë etj.

mërorët 1...4 kjo mungesë është më e motivueshmë për shkak të dendurisë më të madhe të përdorimit dhe të karakteristikave të ndryshme morfolologjike në zanafillë (shén. 8), për numërorin pesë < *penkue kjo mungesë mbetet për t'u svaruar³⁸.

§ 5. Zbërthimi bindës i çështjeve të shtruara më lart (§§ 4v.) do të lejonte një trajtim të saktë edhe në svarimin e arsyeve të shfaqjes së formantit -të në shqipe te numërorët në shqyrtim. Me të dhënët e deri-sotme historiko-gjühësore që po parashtrohen në këtë trajtesë, rezulton më shumë që ky formant të ketë pasur në zanafillë funksion mbiemër (< *t(o)). E në këto rrëthana, merr rëndësi të veçantë teza e Fr. Bopit (shih § 1) që vëren këtu formantin e rreshtorëve gjegjës *to > -të : i dytë, i gjashtë, i dhjetë etj. Një shtim i tillë analogjik duket i motivueshmë në një përiudhë kur numërorët rreshtorë të shqipes, ashtu si edhe klasa e mbiemrave të nyshëm ishin paranyjëzuar me të ashtuquajturën nyjë të përparme: i gjashtë : gjashtë, i shtatë : shtatë, i tetë : tetë etj. Ky deduksion të çon deri në periudhën parasllave të shqipes³⁹. Kurse në të mirë të mendimit për një ndikim analogjik më të hershëm po sjellim edhe dy argumente të tjera:

a) Reziku i ngatërrimit të funksioneve të dy palë numërorëve më-njanohet disi edhe nga topika e tyre. Kështu, ndërsa themelorët në sintagmat numëror-emër dalin vetëm të paravendosur, rreshtorët përkundrazi i janë prapavendosur emrit, të cilin përcaktojnë.⁴⁰

b) Në një fazë të caktuar të evolucionit të shqipes, numërorët themelorë rezultojnë të reduktuar fonetikisht si fjalë njërrökëshe. Në këtë mënyrë shtimi i formantit -të është më se i mundshëm, duke i shndërruar ata në fjalë trokaike, ashtu si pjesa më e madhe e fjalëve në shqipe^{40/1} (me përjashtim të foljeve):

*sùéks: shq. gjasht-, ku *se > shq. gja, khs. *serpens > gjarpën, ndërsa *ks > sh, khs. : i.e. *ekst- > shq. jashtë i.e. *puks > push.

*séptm: në shkallën zero *sptm: shq. shtá-; ku *spt > °st > sht, si gr. osteon: shq. ashtë etj.; ndërsa -m > °-eN > a.

*oktōu: shq. tē-, ku o- > ø, k't > t si lat. noctis: shq. natë etj. dhe ö > ē gr. πωλῶς : shq. pelë; lat. nōs: shq. nē, lat. pomum: shq. pemë.

*néyn: shq. tosk./nēn- / geg. nan⁻⁴¹

38) Shih Pedersen, KZ, 36, f. 287. Ndërsa H. Eichner në disertacionin e tij *Die Zahlwörter* e sjell këtë numëror nga një formë parashqiptare e rindërtuar *penku-ti-ā, nëpërmjet zhvillimeve fonetike të pjesës së dytë të fjalës *kytiā > °tia > -sé. Porsi i pranon edhe vetë vështirësitet e karakterit morfoligjik që dalin nga pranimi i një formanti të mundshëm *-ti- vetëm për këtë numëror.

39) Shih Sh. Demiraj, *Sistemi i lakimit...*, f. 165-166.

40) Më hollësisht shih Sh. Demiraj, *Vendi i përcaktorëve në gjuhën shqipe*, SF, 3, 1981, f. 75 dhe *Sistemi i lakimit...*, f. 204 v.

40/1 Për një pjesë përforcuese *-to në shqipe tek një numër fjalësh, shih tek N. Jokl, *Marrédhëniet e aférise...*, SF, 3, 1967, f. 125.

41) Etimologjia e kësaj fjalë përfazën e protoshqipes mbetet e errët. Në rast se ka pasur në rrënje të saj zanoren -e-, kjo zanore mund të jepte -a- në gegërishtë dhe -ē- në toskérishë krhs. shq. ashtë / éshë < *en esti; lat. lat arena > shq. geg. rānē, tosk. rērē. Nëqoftëse zanoria e rrënjes ka qenë një o e shkurtër, ajo ka dhënë rregullisht a, e cila para një nazaleje ka dhënë në tosk. ë, geg. a. Shih edhe G. Meyer, *Alb. Studien*, III, f. 61-, 83, 87.

*dék^m: shq. *dhje-*; ku *d- > *dh-* si tek *da- «me dhënë»: shq. *dha-*, *dighā «dhi» = shq. *dhi* etj. dhe e > ié si tek *b^her-: shq. *bier*; *d^héghō: alb. *dieg* etj.; (për fatin e tingujve fundorë shih § 4.2.1.)

6. Nga sa u shtjellua deri këtu, del se në gjuhën shqipe të disa numërorë të trashëguar nga gjuha bazë indoевropiane (numërorët *gjashtë*, *shtatë*, *tetë*, *nëntë dhjetë*) janë kryer ndryshime të karakterit strukturor fjalëformues, por pa prekur sado pak lidhjet etimologjike me tipin e lashtë indoevropian. Këto ndryshime të përfutura në truail të shqipes i kanë dhënë asaj një fizionomi të vetën e të dallueshme nga gjuhët e tjera si-motra. (§§ 4.1; 4.2.1; 4.2.2).

6.1. Në këtë pikë shqipja nuk paraqet të vetmin rast ndër gjuhët e ndryshme i.e. Një proces i ngjashëm në mënyrën e formimit të fjalës *dhjetë* si element përbërës i rrafshit dhjetësh të numërimit ka ndodhur edhe në sllavishten e vjetër. Tanimë pranohet si e përligjur teza e hedhur në fillim nga Miklosici dhe e shtjelluar më tej nga Leskieni, sipas së cilës numërorët 5...10: *pët_b*, *sëst_b*, *sedm_b*, *osm_b*, *devët_b*, *desët_b* janë emra abstraktë femërorë më -b < *-i⁴². Që këtej numërori *desët_b*, duke qenë për nga natyra leksiko-gramatikore një fjalë emër me kuptimin «një dhjetëshe», erdhi e u përdor edhe si element përbërës i rrafshit dhjetësh të numërimit, pa pësuar ndonjë ndryshim fjalëformues: *dva desëti* (Em. Kall., dual), *tri desëte* (Em. Kall., shumës), *pët_b desët_b* (Gjin. shumës) etj.

Por duhet të vëmë në dukje këtu se ajo që e afrojn shqipen me sllavishten e vjetër, e që këtej edhe me gjuhët e reja sllave, qëndron vetëm në rrugën e përfthimit të elementit përbërës të rrafshit dhjetësh. Ndërsa në shumë piaka secila gjuhë ka ndjekur rrugët e veta.

a) Në sllavishten e vjetër u përdorën me funksionin e numërorëve (për numërorët 5...10), emrat abstraktë me -b të formuar nga rreshtorët gjegjës. Në gjuhën shqipe këta numërorë janë formime më -të me funksion mbiemëror. Ndonjë supozim i mundshëm, që edhe te numërorët 6...10 të gjuhës shqipe të ketë qenë dikur i pranishëm formanti *-i, nuk del i përligjur edhe nga pikëpamja fonetike⁴³.

b) Në të dyja gjuhët elementi përbërës që shenjonte rrafshin dhjetësh: shq. -*dhjetë*; sll. e vj. *deset-*, duke qenë në zanafillë emër, i nën-shtrohej po atij reksioni të cilit i nënshtroheshin edhe emrat e tjerë në

42) Fr. Miklosich, *Vergleichende Grammatik...*, II, f. 161; A. Leskien, *Grammatik der altslawischen Sprache*, 1981 (bot. III), f. 149-150. Kjo tezë bie ndesh me tezën që sheh tek numërorët 5...10, formantin *-ti > sll. e vj. -tb. Tani është vërtetuar që pjesa përmbyllëse -tb tek numërorët 5...10 të kësaj gjuhe është një bashkim dy formantesh -tb + -b, ku -tb < *-to është një element fjalëformues mbiemëror që del edhe tek rreshtorët, ndërsa -b < *-i është një formant që shërbente për formimin e emrave abstraktë. Shih dhe Simenschy-Ivănescu, *vep. cit.*, f. 310-311 dhe 278.

43) Siç dihet, edhe në gjuhën shqipe me anën e formantit -i < *-i ndërtohen emra abstraktë a kolektivë të gjinisë femërore, prej temash emërore: *blektór-blektori*, prej temash mbiemërore: *i búkur-bukuri*, prej temash follore: *dredh-dredhi*, prej temash ndajfollore: *tépér-teprí*. Por në shqipe kjo prapashtesë bart edhe theksin e fjalës mbi vete. Prandaj, në rast se kjo prapashtesë do të kishte qenë e pranishme edhe tek numërorët 6...10, atëherë ajo, duke bartur edhe theksin, nuk do të ishte errësuar në -ë. Për faktet e tjera që vijnë në të mirë të këtij argumenti shih edhe § 2, si edhe pikat b,c të këtij paragrafi.

togfjalëshat numërorë i thjeshtë + emër. Kështu, në sllavishten e vjetër rolin kryesor për nga pikëpamja gramatikore e luante vetë numërori (për numërorët 5...9), ndërsa emri *deset-* dilte në rasën gjinore shumës: *pëtë desëtë «50», devëtë desëtë «90»*. Në gjuhën shqipe këtë rol e kryente vetë emri *dhjetë < +dék- tā* (Sh. shën 33) i përcaktuar nga numërorët e thjeshtë: *gjashtëdhjetë, tetëdhjetë si tridhjetë, pesëdhjetë*.

c) Dallime vërehen edhe kur shqyrtohet zhvillimi i reksionit sintaksor të numërorëve në përgjithësi për këto dy gjuhë. Në gjuhën shqipe e gjithë klasa e numërorëve, duke përfshirë këtu edhe numërorët kompozita 30, 50...90, funksionon si përcaktor i vetëmjaftueshëm i gjymtyrës që përcakton. Shemb: *tre burra, katërbëdhjetë djem, tridhjetë vajza* etj. Në sllavishten e vjetër, por edhe në gjuhët e reja sllave (§ 2), klasa e numërorëve funksionon si një gjymtyrë kryesore që drejton në rasë gjymtyrën që kuptimisht përcakton. Shemb *pëtë ženë «pesë gra», shëstë na desete maži⁴⁴ «gjashtëdhjetë burra», osmë desetë ženë «tetëdhjetë gra»; rus. пятнадцать студентов «pesëmbëdhjetë studenta», тридцать студентов «tridhjetë studente»* etj.

6.2. Një proces i ngjashëm me atë të shqipes vihet re edhe në mënyrën e organizimit të rrafshit dhjetësh të numërimit në gjuhën rumune. Kjo gjuhë largohet në këtë pikë nga nëna e saj latinishtja dhe nga gjuhët e tjera romane.

Ngjashmëria me shqipen qëndron në faktin se numërori *zece «dhjetë»* (lat. *decem*), me funksion mbiemëror shërben edhe si temë fjalëformuese për ndërtimin e elementit përbërës me funksion emëror të rrafshit dhjetësh të numërimit. Edhe në këtë rast kalimi në klasën e emrit bëhet me anë konversioni. Shemb: *douăzeci, treizeci* etj. «njëzet», «tridhjetë». Veçse këto dy gjuhë afrohen me njëra-tjetërën vetëm në mënyrën e organizimit të numërorëve dhjetësh. Ato ndryshojnë nga njërat-tjetra në strukturën e numërorëve të thjeshtë⁴⁵ dhe kompozita⁴⁶, e mësë fundi edhe në reksionin sintaksor të numërorëve dhjetësh në togfjalëshat numëror + emër⁴⁷. Kështu, ndërsa në shqipe kompozitat dhjetë-

44) Në sllavishten e vjetër për numërorët 11-19 emri që shenjonte objektin e numëreshëm drejtohej në rasë nga elementi i parë i shprehjes (numërorët 1...9). Shemb: *dva na desete maža*, (dual) «dymbëdhjetë njerëz», *trije na desete maži* (Em. Kall. shumës) «treimbëdhjetë njerëz», *pëtë na desete maži* (gjin. shumës) «pesëmbëdhjetë njerëz». Në gjuhët e reja sllave kjo strukturë ka ndryshuar me përfitim e përngjitur. Të gjithë numërorët e përngjitur 11...19 e kërkoijnë emrin që kuptimisht përcaktojnë në rasën gjinore shumës. Shemb: sr.kr. *dvanest konja* «dymbëdhjetë kuaj»; rus. *тринацать студентов* «treimbëdhjetë studenta» etj.

45) Në rumanishte numërorët 1...10 janë fjalë të parme të trashëguara nga latinishtja. Shih edhe Bolocan, *Obstervatii asupra originii numeralor românești*, në «Limba română», II 1969, f. 133.

46) Shih për gjuhën shqipe § 5. Për rumanishten shih I. Coteanu, *Morfologia numelui în protoromână*, Bucureşti, 1969, f. 153-157; dhe artikullin *În legătură cu structura numeralului românesc*, në «Limba română», II 1969, f. 137-139; Ch. Bolocan, *art. cit.*, f. 133-137.

47) Shih I. Coteanu dhe Ch. Bolocan në veprat e tyre të cituara. Njëpjesë e shëbe gjuhëtarëve rumunë mbështesin të zënë një kalkimi strukturor të numërorëve kompozita të rumanishtes sipas sllavishtes. Shih ndër të tjera A. Rosetti, *ILR III* (bot. 4), f. 52. qd. fjalë shëbe ia është shëbe illos inskringur (Nëz. është

tështë janë shndërruar që herët në kompozita me funksion mbiemëror, në rumanishtë ruhet karakteri emëror i fjalës zece (sh. zeci). Në sintagmat numëror kompozitë + emër, emri vihet në funksionin e një përcaktori të pjesës që lidhet me numërорin kompozitë me anën e parafjalës *de*, p.sh.: *douăzeci de oameni* «njëzet njerëz», *treizeci de oameni* «tridhjetë njerëz» etj. Në dialektin arumun këto marrëdhënie partitive dalin edhe për numëroret 11...19: *dosprățați dī locuri* «dymbëdhjetë pjesë».

Nga sa u shtjellua në këtë punim mund të theksohen këto përfundime të përgjithshme:

1) Në gjuhën shqipe, tek disa numërore themelorë: *gjashtë*, *shtatë*, *tetë*, *nëntë*, *dhjetë*, janë përfshuar ndryshime të karakterit strukturor fjalëformues, pa prekur sado pak marrëdhëni etimologjike me tipin e lashtë indoevropian (§§ 1-2). Këto ndryshime të përfshuara në truall të shqipes i kanë dhënë asaj një fizionomi të vetën, të dallueshme nga gjuhët e tjera simotra indoevropiane. (§§ 6-6.2).

2) Këto ndryshime lidhen me shtimin e formantit -të që në bazë të funksionit klasifikues mbiemëror rezulton të jetë i prejardhur nga prapashtesa i.e. *-t(o). (§§ 3-4).

3) Për vetë paraqitjen fonetike dhe funksionin klasifikues mbiemëror formanti -të <*-t(o)> duhet të shihet i lidhur ngushtë me formantin e rreshtarëve *-to-> shq. -të (*i gjashtë*, *i shtatë* etj.). Për pasojë edhe një ndikim analogjik i rreshtarëve përkatës del plotësisht i mundshëm (§ 5.).

Zusammenfassung

DAS FORMANS -të IM ZAHLENSYSTEM DER ALBANISCHEN SPRACHE

Der Ursprung des Formans -të bei den Grundzahlwörtern 6...10 (*gjashtë* «sechs», *shtatë* «sieben», *tetë* «acht», *nëntë* «neun», *dhjetë* «zehn») der albanischen Sprache ist stets in engem Zusammenhang mit dessen ursprünglicher Funktion gesehen worden, worfür die verschiedenen Sprachwissenschaftler zwei prinzipielle Möglichkeiten in Betracht gezogen haben. Entweder soll dieses Formans zur Bildung von Ordnungszahlwörtern gedient haben, welche zu einer bestimmten Zeit auch als Grundzahlwörter Verwendung fanden (idg. *-to: gr. -*to*, lat. -*to* aslav. -*tb*, alb. -*to* etc), oder aber diente es ursprünglich zur Bildung abstrakter oder kollektiver Substantiva (Zahlabstrakta), indem es mit einem idg. *-ti: ai. -*t*, -*tí*, gr. -*αδος* aslav. -*tb*, lit. -*ti* gleichsetzt. Eine dritte Möglichkeit besteht daraus, dass der Ursprung dieses Formans auf einer Grundform des Kardinalzahls für «Zehn»; idg. *dékmt- zurückgeht. (§ 1).

In dem vorliegenden Aufsatz wird versucht, nach einer kritischen Prüfung der aufgestellten Thesen, neue Argumente in Zusammenhang mit den Fragen des Ursprungs, der ursprünglichen Funktion dieses Formans und dessen anfänglichen Verbreitungsgrades vorzubringen. Auf Grund einer detaillierten Analyse auf morphologisch-syntaktischem und phonologischem Ebene, ist der Autor zu folgenden Abschlüssen gekommen:

1. In der albanischen Sprache sind von ihren ältesten schriftlichen Zeugnissen an und unter Einbeziehung auch der Diasporamundarten keinerlei Spuren einer Verwendung der Kardinalien 6...10 in substantivischer Funktion zu finden, das das von ihnen zu zählende Objekt bezeichnet, im Genetiv oder in einem anderen abhängigen Fall stehen müsste, wie in den verschiedenen idg. Sprachen, welche das Formans **-ti* erhalten haben (§ 2).

2. Die einzige Funktion des wortbildenden Elementes *-të* im Albanischen, ist die Bildung von Adiktiva. Und in dieser Funktion kann es nur aus idg. **-to* abgeleitet sein. (§§ 30...3,2).

3. In Anbetracht der bisherigen Daten der historischen Phonologie des Albani-schen halten wir es am angebrachtesten zu meinen, dass es sich bei dem Endelement *-t-* des Wortes *dhjetë* «Zehn» um ein später suffigiertes Element handelt und damit die These des Ursprungs dieses Formans aus einer angeblichen Grundform des Zahlwortes «Zehn», was das Albanische betrifft, nicht vor der Kritik stehen kann. (§§ 4...4.2.1.) Dieses Formans hat ursprünglich im Albani-schen zur Bildung des entsprechenden Zahlwortes gedient und erst später auch als Bestandteil der Zehnerkomposita des Zahlensystems Verwendung fand. (§ 4.2.2.).

4. Auf denselben Schlussfolgerungen führt auch die phonologische und die wortbildungs — Analise bei den anderen Zahlwörter: *gjashtë* «sechs» bis *nëntë* «neun» an. (§ 4.2.3.).

5. Ausgehend von diesen linguistischen Tatsachen sehen wir Bopps These sehr möglich zu sein, der zufolge, ist in den zur Frage stehenden Zahlwörtern das Suffix der entsprechenden Ordnungszahlwörter enthalten. Eine solche Analogiebildung scheint in der Periode, in der die Ordnungszahlwörter des Albanischen ebenso wie auch eine Klasse von Adiktiva den sogenannten prä-positiven Artikel bekommen hatten, mehr als möglich: *i gjashtë* «sechster» gegenüber *gjashtë* «sechs», *i shtatë* «siebenter» gegenüber *shtatë* «sieben» etj. (§ 5).

Für die Auffassung, es hätte eine frühere Beeinflussung mittels Analogie von seiten der entsprechenden Ordnungszahlwörter stattgefunden, haben wir noch zwei weitere Argumente vorzubringen:

a) Die Gefahr einer Verwischung der Funktionen der beiden Zahlwortgruppen wird in gewisser Weise auch durch deren Topik vermieden. Während die Grundzahlwörter in den Syntagmen mit einem Substantiv nur vorangestellt vorkommen, sind die Ordnungszahlwörter dem Substantiv, auf das sie sich beziehen, nachgestellt.

b) In einer bestimmten Entwicklungsphase des Albanischen scheinen die Kardinalzahlen phonetisch als einsilbige Wörter reduziert zu sein. Und damit ist bei denen die Hinzufügung des adjektivischen Suffixes *-të* < **-to* sehr möglich, um auf diese Weise zu trochäischen Wörtern zu werden, wie dies der Grossteil der Wörter im Albanischen (mit Ausnahme der Verben) ist. (§ 5).

7. Solche Veränderungen im Zahlensystem haben der albanischen Sprache eine eigene Physiognomie in der Mite der idg. Sprachfamilie zugegeben. (§§ 6...6.2.).